



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenin 22, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 8, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, të Ligjit nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave, Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2014, miratoi këtë:

## **Rregullore për Pagesat Ndërkombëtare**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) nëpërmjet kësaj Rregullore përcakton kërkesat për përmbajtjen e urdhërpagesave ndërkombëtare, kushtet e pranimit dhe ekzekutimit të tyre, si dhe obligimet për raportimin e tyre.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha bankat, degët e bankave të huaja dhe institucionet e tjera financiare të autorizuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave ndërkombëtare në Republikën e Kosovës.

#### **Neni 3 Përkufizimet**

Në zbatim të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "transaksion pagese" nënkupton një transfer fondesh nga paguesi te i paguari;

- b) "shërbim pagese" nënkupton një veprimtari të autorizuar të institucioneve financiare, që mundëson ekzekutimin e transaksioneve të pagesës, duke përfshirë edhe veprimtarinë e remitancave të parave;
- c) "pagesë ndërkombëtare" nënkupton një transaksion pagese, ku ofruesi i shërbimit të pagesës për paguesin ose ofruesi i shërbimit të pagesës për të paguarin gjendet jashtë Kosovës;
- d) "pagesë ndërkombëtare dalëse" nënkupton një pagesë ndërkombëtare, ku ofruesi i shërbimit të pagesës për paguesin gjendet në Kosovë, ndërsa ofruesi i shërbimit të pagesës për të paguarin gjendet jashtë Kosovës;
- e) "pagesë ndërkombëtare hyrëse" nënkupton një pagesë ndërkombëtare, ku ofruesi i shërbimit të pagesës për paguesin gjendet jashtë Kosovës, ndërsa ofruesi i shërbimit të pagesës për të paguarin gjendet në Kosovë;
- f) "urdhërpagesë ndërkombëtare" nënkupton një urdhër nga paguesi, që i është dhënë një ofruesi të shërbimit të pagesës, që urdhëron atë për të iniciuar pagesën ndërkombëtare;
- g) "pagues" nënkupton një person fizik a juridik që inicion urdhërpagesën ndërkombëtare;
- h) "i paguar" nënkupton një person fizik a juridik, që është përfitues i fundit në bazë të urdhërpagesës ndërkombëtare;
- i) "ofrues i shërbimit të pagesës" nënkupton institucionin e licencuar nga BQK-ja për të ofruar shërbime të pagesës ndërkombëtare;
- j) "ndërmjetësues i shërbimit të pagesës", në kuadër të një transaksioni pagese, nënkupton një bankë a degë banke të huaj, e cila nuk është pagues ose ofrues i shërbimit të pagesës për të, si dhe as i paguar ose ofrues i shërbimit të pagesës për të, por e cila ndërmjetëson mes institucioneve financiare në procesin e ekzekutimit të transaksionit të pagesës ndërkombëtare;
- k) "pranim formal i urdhërpagesës ndërkombëtare" nënkupton dhënie pëlqimi nga ofruesi i shërbimit të pagesës për të procesuar pagesën ndërkombëtare në bazë të urdhërpagesës ndërkombëtare; me pranimin formal të urdhërpagesës ndërkombëtare, ofruesi i shërbimit të pagesës pranon përgjegjësinë për procesimin e saj;
- l) "udhëzim" nënkupton një rekomandim me shkrim të lëshuar nga BQK-ja, që ka aplikim të përgjithshëm dhe është i detyrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit dhe drejtpërdrejt i zbatueshëm;
- m) "remitancë e parave" nënkupton një shërbim të pagesave ku fondet pranohen nga një pagues, pa krijuar ndonjë llogari në emër të paguesit apo të të paguarit, me qëllim të vetëm të transferit të shumës përkatëse tek i paguari apo në një institucion tjetër të pagesave, që vepron në emër të të paguarit dhe/ose kur fondet e tilla pranohen në emër të të paguarit dhe vihen në dispozicion të tij;
- n) "BBAN" (Basic Bank Account Number) nënkupton numrin bazë të llogarisë bankare, i cili paraqet një kod numerik, që identifikon në mënyrë unike llogarinë bankare brenda vendit;

- o) "IBAN" (International Bank Account Number) nënkupton numrin ndërkombëtar të llogarisë bankare, i cili paraqet një kod alfanumerik, që është një version i zgjeruar i BBAN-it dhe që identifikon në mënyrë unike llogarinë bankare në nivel ndërkombëtar; ai përcaktohet në përputhje me Standardin Ndërkombëtar ISO 13616.

## **KAPITULLI II PAGESAT NDËRKOMBËTARE DALËSE**

### **Neni 4**

#### **Përmbajtja e urdhërpagesës ndërkombëtare dalëse**

Në urdhërpagesën ndërkombëtare dalëse duhet të përmbahen së paku të dhënat e mëposhtme:

- a) Emri, adresa dhe numri i llogarisë së paguesit, që mund të jetë IBAN-i ose BBAN-i; në rast të remitancave të parave, në vend të numrit të llogarisë paraqitet numri personal/i regjistrimit të paguesit;
- b) Emri, adresa dhe numri i llogarisë së të paguarit; në rast të remitancave të parave, nuk paraqitet numri i llogarisë së të paguarit;
- c) Emri, adresa, kodi SWIFT (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication) BIC (Business Identifier Code), kodi ABA (American Bankers Association) apo tjetër kod unik i pranueshëm i ofruesit të shërbimit të pagesës për të paguarin;
- d) Shuma dhe valuta e pagesës;
- e) Data për procesim të urdhërpagesës ndërkombëtare nga ana e ofruesit të shërbimit të pagesës për paguesin; dhe
- f) Të dhënat mbi pagesën:
  - i) për informim të të paguarit;
  - ii) për raportim në Sistemin e Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare për përpilimin e bilancit të pagesave, të cilat përcaktohen me udhëzim të veçantë; dhe
  - iii) për identifikim unik të saj, të cilat përcaktohen me udhëzim të veçantë.

### **Neni 5**

#### **Pranimi i urdhërpagesës ndërkombëtare dalëse**

1. Paguesi mund ta paraqesë për ekzekutim te ofruesi i shërbimit të pagesës urdhërpagesën ndërkombëtare dalëse, e cila duhet të jetë e autorizuar në mënyrën e kërkuar nga ofruesi i shërbimit të pagesës.
2. Një ofrues i shërbimit të pagesës obligohet ta bëjë pranimin formal të urdhërpagesës ndërkombëtare të paraqitur nga paguesi, në qoftë se të gjitha parakushtet e mëposhtme janë plotësuar:
  - a) urdhërpagesa është paraqitur tek ofruesi i shërbimit të pagesës sipas kushteve të rëna dakord;

- b) paratë e nevojshme për ekzekutimin e pagesës janë vënë në dispozicion të ofruesit të shërbimit të pagesës;
  - c) ofruesi i shërbimit të pagesës ka rënë dakord me paguesin mbi pagesën e tarifave përkatëse;
  - d) data për procesim e dhënë në urdhërpagesë i lejon ofruesit të shërbimit të pagesës respektimin e saj; dhe
  - e) ekzekutimi i pagesës nuk shkel ndonjë dispozitë të ligjeve, rregulloreve ose udhëzimeve të zbatueshme për ofruesin e shërbimit të pagesës.
3. Në rast të mosbërjes së pranimi formal, më së largu deri në fund të ditës së ardhshme të punës nga dita e paraqitjes paguesi duhet të njoftohet dhe duhet t'i rivihen në dispozicion paratë përkatëse.

## **Neni 6**

### **Ekzekutimi i urdhërpagesës ndërkombëtare dalëse**

1. Procesimi i urdhërpagesës ndërkombëtare dalëse nga ana e ofruesit të shërbimit të pagesës do të bëhet deri në fund të ditës së ardhshme të punës nga dita e pranimi formal, përveç nëse dakordohet ndryshe mes ofruesit të shërbimit të pagesës dhe paguesit.
2. Procesimi i urdhërpagesës ndërkombëtare dalëse nga ana e ndërmjetësit vendor të shërbimit të pagesës, do të bëhet brenda ditës së bartjes së saj te ndërmjetësuesi vendor i shërbimit të pagesës prej ofruesit të shërbimit të pagesës për paguesin.
3. Nëse një urdhërpagesë ndërkombëtare dalëse paraqitet pas mbylljes së ditës së punës ose pas periudhës kohore të caktuar, ajo mund të trajtohet si e nisur në fillim të ditës së ardhshme të punës.
4. Kur gjatë ekzekutimit të një pagese bartet një urdhërpagesë ndërkombëtare dalëse nga:
  - a) ofruesi i shërbimit të pagesës për paguesin tek ofruesi i shërbimit të pagesës për të paguarin ose te një ndërmjetësuesi i shërbimit të pagesës; ose
  - b) ndërmjetësuesi vendor i shërbimit të pagesës te një ndërmjetësues tjetër i shërbimit të pagesës apo tek ofruesi i shërbimit të pagesës për të paguarin;duhet të përcillen të dhëna të nevojshme për procesimin adekuat të saj dhe informimin e duhur të të paguarit.
5. Ofruesi i shërbimit të pagesës për paguesin dhe ndërmjetësuesi vendor i shërbimit të pagesës janë të obliguar për të kontraktuar ndërmjetësues të huaj të shërbimit të pagesës, të cilët kanë autorizimet e duhura në shtetet ku gjenden, si dhe kapacitetet e nevojshme për kryerjen e shërbimit të pagesës.

## **KAPITULLI III PAGESAT NDËRKOMBËTARE HYRËSE**

### **Neni 7**

#### **Përmbajtja dhe pranimi i urdhërpagesës ndërkombëtare hyrëse**

1. Në urdhërpagesën ndërkombëtare hyrëse duhet të përmbahen së paku të dhënat e mëposhtme:
  - a) Emri dhe adresa e paguesit;
  - b) Kodi (SWIFT BIC, ABA apo tjetër kod unik i pranueshëm) ose emri dhe adresa e ofruesit të shërbimit të pagesës për paguesin;
  - c) Emri, adresa dhe numri i llogarisë së të paguarit, që mund të jetë IBAN-i ose BBAN-i; në rast të remitancave të parave, nuk paraqitet numri i llogarisë së të paguarit;
  - d) Shuma dhe valuta e pagesës; dhe
  - e) Të dhënat mbi pagesën për informim të të paguarit.
  
2. Në rast se të dhënat e kërkuara në paragrafin 1. të këtij neni mungojnë ose nuk janë të plota në urdhërpagesën ndërkombëtare hyrëse, brenda ditës së ardhshme të punës ofruesi i shërbimit të pagesës për të paguarin duhet të kërkojë ofrimin ose plotësimin e tyre nga ndërmjetësuesi i shërbimit të pagesës, ofruesi i shërbimit të pagesës për paguesin ose i paguari.
  
3. Në rast se të dhënat e kërkuara sipas paragrafit 2. të këtij neni
  - a) sigurohen, por nuk janë adekuate; ose
  - b) nuk sigurohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore;nuk bëhet pranimi formal dhe urdhërpagesa ndërkombëtare hyrëse duhet të kthehet prapa.
  
4. Në rast se të dhënat mbi pagesën për raportim në Sistemin e Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare për përpilimin e bilancit të pagesave, të cilat përcaktohen me udhëzim të veçantë, nuk mund të nxirren nga urdhërpagesa ndërkombëtare hyrëse, ofruesi i shërbimit të pagesës për të paguarin do të kërkojë sigurimin e tyre nga i paguari.

### **Neni 8**

#### **Ekzekutimi i urdhërpagesës ndërkombëtare hyrëse**

1. Procesimi i urdhërpagesës ndërkombëtare hyrëse nga ana e ofruesit të shërbimit të pagesës për të paguarin do të bëhet deri në fund të ditës së ardhshme të punës nga dita e pranimin formal, përveç nëse dakordohet ndryshe mes ofruesit të shërbimit të pagesës dhe të paguarit.
  
2. Procesimi i urdhërpagesës ndërkombëtare hyrëse nga ana e ndërmjetësuesit vendor të shërbimit të pagesës, do të bëhet brenda ditës së bartjes së saj te ndërmjetësuesi vendor i shërbimit të pagesës prej ofruesit të shërbimit të pagesës për paguesin ose një ndërmjetësuesi tjetër i shërbimit të pagesës.
  
3. Nëse një urdhërpagesë ndërkombëtare hyrëse bartet pas mbylljes së ditës së punës ose pas periudhës kohore të caktuar, ajo mund të trajtohet si e bartur në fillim të ditës së ardhshme të punës.

4. Kur gjatë ekzekutimit të një pagese merret një urdhërpagesë ndërkombëtare hyrëse nga ofruesi i shërbimit të pagesës ose prej ndërmjetësuesit të shërbimit të pagesës, duhet të evidentohen të dhëna të nevojshme për procesimin adekuat të saj dhe informimin e duhur të të paguarit.
5. Ofruesi i shërbimit të pagesës për të paguarin dhe ndërmjetësuesi vendor i shërbimit të pagesës janë të obliguar për të kontraktuar ndërmjetësues të huaj të shërbimit të pagesës, të cilët kanë autorizimet e duhura në shtetet ku gjenden, si dhe kapacitetet e nevojshme për kryerjen e shërbimit të pagesës.

## **KAPITULLI IV RAPORTIMI RREGULLATOR**

### **Neni 9 Shërbimi i raportimit rregullator**

1. Bankat dhe degët e bankave të huaja që janë të lidhura në sistemin SWIFT, obligohen të regjistrohen në Shërbimin e Raportimit Rregullator të BQK-së, i cili shërbim operohet përmes sistemit SWIFT.
2. Bankat dhe degët e bankave të huaja që janë të lidhura në SWIFT, por që përkohësisht përdorin aranzhime alternative të komunikimit për pagesat e tyre ndërkombëtare, obligohen t'i raportojnë ato në mënyrën e përcaktuar nga BQK-ja me udhëzim të veçantë.

## **KAPITULLI V NDËSHKIMET**

### **Neni 10 Ndëshkimet**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Sistemin e Pagesave.

## **KAPITULLI VI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 11 Udhëzimet**

Bordi Ekzekutiv i BQK-së mund të lëshojë udhëzime për të zbatuar dispozitat e përcaktuara me këtë Rregullore.

**Neni 12**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Pagesat Ndërkombëtare e miratuar më 26 dhjetor 2013.

**Neni 13**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 2 shkurt 2015.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore

---

Bedri Peci